

**Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve ekonomik “Alb-Building” shpk & “Delia Group” shpk**  
**Adresa: Njësia Bashkiake Nr. 9, Rruga “Asim Vokshi”, ndërtesa Nr. 14, hyrja 4, apartamenti 6, Kodi Postar 1016, Tiranë**

### **FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur” “Itenerarë këmbësorësh me pistë vrapimi dhe biçikletash në Parkun e Liqenit Artificial”**

**Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Itenerarë këmbësorësh me pistë vrapimi dhe biçikletash në Parkun e Liqenit Artificial”**

**Fondi limit: 256,319,729.17** (dyqind e pesëdhjetë e gjashtë milion e treqind e nëntëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzetë e nëntë pikë shtatëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

**Burimi i financimit:** vënë në dispozicion nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve me Vendimin Nr. 31, datë 13.06.2016 “Për shpërndarjen e financimit për projekte të Grantit “Infrastruktura Vendore dhe Rajonale”, Programi “Zhvillimi i Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale”, Shtylla I, Thirrja II, për vitin 2016”, rialokuar me shkresën me Nr. 2083 Prot. datë 06.03.2017 nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, përcjellë për kompetencë me shkresën me Nr. 9194 Prot. datë 08.03.2017.

**Kohëzgjatja e kontratës:** 20 (njëzetë) javë kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 08.05.2017, ora 11:00**

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 15 datë 18.04.2017.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Alb-Building” shpk & “Delia Group” shpk**  
**NUIS J69102508C & NUIS J81517002U**

Vlera e ofertës = **197,635,665.74** (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e tridhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

## **2. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “BE-IS” shpk & “Egland” shpk**

**NUIS K71412003A & NUIS J96829419**

Vlera e ofertës = **203,569,464** (dyqind e tre milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

## **3. Operatori ekonomik “Curri” shpk NUIS J67902718S**

Vlera e ofertës = **226,784,775** (dyqind e njëzetë e gjashtë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

## **4. Operatori ekonomik “Alko-Impex General Construction” Degë e shoqërisë së huaj NUIS K91326028I**

Vlera e ofertës = **251,475,788** (dyqind e pesëdhjetë e një milion e katërqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

**Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:  
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

### **1. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “BE-IS” shpk & “Egland” shpk**

**NUIS K71412003A & NUIS J96829419**

- Shoqëria “BE-IS” shpk nuk plotëson pikën 4 të Kapacitetit teknik: “Një punësim mesatar i të paktën 140 (tetëdhjetë) personave, për periudhën Shkurt 2016 - Shkurt 2017 të vërtetuar me...”, pasi rezulton të ketë të nënshkruara me Bashkinë Tiranë, 3 kontrata respektivisht me objekt: 1. “Rikualifikim urban i bllokut nr.1 Laprake, kufizuar nga rruga Don Bosko - Shina e Trenit Finlanto - Turhan Pashë Përmeti - Ibrahim Pashë Bushatlliu - Lord Bajrom - Riza Cuka - Learton Vathi - Pandi Dardha - Dritan Hoxha “në të cilën ka të angazhuar 60 punonjës, 2. “Rikonstruksion i rruges se Zallit” në të cilën ka të angazhuar 23 punonjës, 3. “Rruga për në fshatin Kasallë (degëzimi nga Cerkezi-Cinan), rreth 2 km” në të cilën ka të angazhuar 24 punonjës. Për periudhën Mars 2017-Mars 2017, ky operator ekonomik posedon një punësim mesatar prej 113 punonjësish dhe duke përjashtuar numrin e punonjësve të angazhuar në kontratat e sipërcituara, numri i punonjësve të pa angazhuar që i takon të përfaqësohet sipas Kontratës së bashkëpunimit, Nr.2589.Rep, Nr.1045.Kol, datë 05.05.2017, rezulton i pamjaftueshëm.
- Shoqëria “BE-IS” shpk nuk plotëson pikën 16 të Kapacitetit teknik: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 9)/Autobitumatrice”, pasi

për mjetin Autobitumatrice të deklaruar në Shtojcën 9 ka paraqitur me faturë dhe jo dokumentacionin përkatës si dhe foto ku të evidentohet targa e mjetit.

- Shoqëria “BE-IS” shpk nuk plotëson pikën 16 të Kapacitetit teknik: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 9)/Autobot Uji-2 copë”, pasi mjeti i deklaruar në Shtojcën 9 si Autobot me targë AA094KS i marrë me qera sipas kontratës së qerasë Nr 3877.Rep, Nr.1565.Kol, datë 18.10.2016, nga verifikimi i dokumentacionit rezulton të jetë kamion. Mjeti me targë AA966RC i deklaruar si Autobot i marrë me qera sipas kontratës së qerasë Nr 2108.Rep, Nr.821.Kol, datë 13.04.2017 rezulton të jetë kamion i certifikuar për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, shoqëruar edhe me faturë tatimore për depozita, cka dëshmon për paraqitjen e një autoboti të montuar kamion+ depozitë. Mjeti me targë AA968JL i marrë me qera sipas kontratës së qerasë Nr 111.Rep, Nr.46.Kol, datë 10.01.2017, nga verifikimi i dokumentacionit rezulton të jetë Autobot karburanti i certifikuar për transport mallrash të rrezikshme brenda vendit.
- Shoqëria “BE-IS” shpk nuk plotëson pikën 16d të Kapacitetit teknik: “*Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit*”, pasi për mjetet Autobetoniere të deklaruara në Shtojcën 9 nuk ka paraqitur foto ku të evidentohen edhe targat.

## **2. Operatori ekonomik “Curri” shpk NUIS J67902718S**

- Operatori ekonomik “Curri” shpk ka paraqitur në sistemin elektronik Vërtetim Debie me Nr. 9/2 Prot. datë 21.04.2017 sipas së cilës rezulton se nuk ka detyrime për faturat e energjisë elektrike deri në datën 21.04.2017 pa përfshirë faturën koherente të muajit Mars 2017. Referuar Nenit 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “*Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë*”, përcaktohet shprehimisht që: “*Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.*
- Vërtetimi i Debisë i paraqitur në sistemin elektronik nga Operatori ekonomik nuk vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për periudhën më të fundit para hapjes së ofertave që tashmë ishte maturuar për procedurën e prokurimit të publikuar më datë 14.04.2017 dhe zhvilluar më datë 08.05.2017.
- Nisur nga sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se Operatori ekonomik “Curri” shpk, nuk plotëson Kriteret e Veçanta për Kualifikim pika 1 gërma “dh” të vendosur në DST, çka bie në kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se “Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur

*rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë.”.*

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për Inxhinierin Gjeolog të deklaruar nga shoqëria “Curri” shpk, konstatoi se mungon Libreza e Punës, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për Inxhinierët e Ndërtimit të deklaruar nga shoqëria “Curri” shpk, konstatoi se mungon Libreza e Punës për njërin nga Inxhinierët, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për punonjësit e pasjitur me dëshmi kualifikimi të deklaruar nga shoqëria “Curri” shpk, konstatoi se për punonjësit teknik ndërtimi nuk janë paraqitur kartelat personale të sigurimit teknik, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 6.
- Operatori ekonomik “Curri” shpk ka deklaruar se ka të punësuar pranë shoqërisë 2 (dy) hidraulik, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 6, ku ndër të tjera përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimumi 11 (njëmbëdhjetë) punonjës të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, të lëshuara nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, nga të cilët:*
  - 3 (tre) elektrikist
  - 2 (dy) saldator
  - 3 (tre) hidraulik
  - 2 (dy) teknik ndërtimi”
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjekun e përgjithshëm të deklaruar nga shoqëria “Curri” shpk, konstatoi se mungon Libreza e Punës si dhe CV, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7.
- Referuar Shtojcës 9, Operatori ekonomik “Curri” shpk ka deklaruar se disponon nëpërmjet Kontratës së Qirasë Autobotin e Ujit me targa TR 9983 R. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë disponueshmërinë e tij, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, gërma “a”.
- Gjithashtu, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se për mjetin Autobitumatriçe, shoqëria “Curri” shpk nuk ka paraqitur Leje qarkullimi, certifikatën e kontrollit teknik si dhe siguracionin e mjetit, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, gërma “a”.

- Shoqëria “Curri” shpk nuk plotëson DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, gërma “d”, pasi për mjetin Autobot uji me targa SH 4082 E, nuk ka paraqitur foto.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Curri” shpk, referuar Shtojcës 9 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

### **3. Operatori ekonomik “Alko-Impex General Construction” Degë e shoqërisë së huaj NUIS K91326028I**

- Referuar Shtojcës 9, Operatori ekonomik “Alko-Impex General Construction” Degë e shoqërisë së huaj ka deklaruar se disponon 3 (tre) Kamiona vetshkarkues minimum 10 ton. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për çdo mjet të deklaruar konstatoi se dy nga Kamionat vetshkarkues me kapacitet mbajtës minimum 10 Ton, ju ka skaduar afati i vlefshmerise se siguracionit te mjetit, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, gërma “a”.
- Referuar Shtojcës 9, Operatori ekonomik “Alko-Impex General Construction” Degë e shoqërisë së huaj ka deklaruar se disponon 3 (tre) Kamiona vetshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5 - 5 ton. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për çdo mjet të deklaruar konstatoi se disponon vetem dy Kamionat vetshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5 - 5 Ton, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16.
- Referuar Shtojcës 9, Operatori ekonomik “Alko-Impex General Construction” Degë e shoqërisë së huaj ka deklaruar se disponon 2 (dy) Autobetoniere përkatësisht me targa 01-166-CM dhe 01-347-HI. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetet e deklaruara si më lart, konstatoi se mjeti me targa 01-347-HI rezulton të jetë Kamion dhe jo Autobetoniere. Për sa më lart në mbështetje të Shtojcës 9, shoqëria “Alko-Impex General Construction” Degë e shoqërisë së huaj disponon vetëm 1 (një) Autobetoniere, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, ku ndër të tjera përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) Autobetoniere”.
- Referuar Shtojcës 9, Operatori ekonomik “Alko-Impex General Construction” Degë e shoqërisë së huaj ka deklaruar se disponon 1 (nje) Asfaltoshtruse me fature doganore F141C. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetet e deklaruara si më lart, konstatoi nuk ka paraqitur dokumentacion shoqërues

me kete mjet, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16.

- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Alko-Impex General Construction” Degë e shoqërisë së huaj, referuar Shtojcës 9 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.
- Gjithashtu Operatori ekonomik “Alko-Impex General Construction” Degë e shoqërisë së huaj nuk ka paraqitur kontrata pune per punonjesit elektrikist, saldator, hidraulik, ndersa per punonjesit teknik ndertimi nuk ka paraqitur asnje dokumentacion, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 6.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Bashkimin e Operatorëve ekonomik “Alb-Building” shpk & “Delia Group” shpk**, me adresë: **Njësia Bashkiake Nr. 9, Rruga “Asim Vokshi”, ndërtesa Nr. 14, hyrja 4, apartamenti 6, Kodi Postar 1016, Tiranë**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **197,635,665.74** (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e tridhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi “Skënderbej”, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 11.05.2017**

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.